



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KOMISIONI STAUTAR PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

Mbështetur në dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komunë (me theks nenin 23), në dispozitat e Rregullores nr.prot.01-016/01-0044979/25 për Transparencë në Komunën e Podujevës (me theks nenet 19 dhe 22), duke vepruar sipas autorizimeve të dhëna me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-020/04-0044925/26 për themelimin e Komisionit Statutar për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës së Podujevës, merr këtë;

V E N D I M PËR VËNIE NË KONSULTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në konsultim publik: **Draft Statuti për Plotësimin dhe Ndryshimin e Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 datë 26.06.2018**

Neni 2

Konsultimi publik sipas këtij Vendimi, zgjat 15 ditë përkatësisht prej datës, **20.08.2026 deri më 03.09.2026**, brenda së cilës Komisioni Statutar mund të organizoj debate / konsultime të ndryshme publike, kurse debati i përgjithshëm publik me qytetarë mbahet më **31.08.2026**, duke filluar nga **ora 13:15** në ndërtesën e Komunës, kati përdhës - salla e mbledhjeve.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten gjatë periudhës së konsultimit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së konsultimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresën; **liridona.rrahmani@rks-gov.net**; të cilat pastaj përcjellën te Kryesuesi i Komisionit Statutar, brenda periudhës së diskutimit/konsultimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: **http://kk.rks-gov.net/podujeve** (rubrika; **aktet për diskutim publik**), në Platformën Qendrore të Konsultimeve Publike, si dhe aty ku Komisioni e vlerëson të nevojshme.

Neni 5

Konsultimi / debati publik zbatohet nga **Komision Statutar për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës së Podujevës**, në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrtaren përgjegjëse për konsultime publike, që përkujdesen për përgatitjen e procesverbaleve & raportit nga konsultimi dhe debati publik si dhe të japin sqarime për arsyeshmërinë e pranimi ose mospranimi të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.Prot.01-016/01-0050698/26
Podujevë, datë; 19 gusht 2026



Kryesuesi i Komisionit
Isak Shabani



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

**KOMISIONI STATUTAR PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E STATUTIT
TË KOMUNËS SË PODUJEVËS**

DRAFT / PROPOZIM

STATUT PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS NR.01-020/01-0050862/18 TË DATËS 29.06.2018

**Podujevë
Gusht 2026**

Komisioni Statutar për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës së Podujevës, duke u mbështetur në Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-020/04-0044925/26 të datës 30 korrik 2026, si dhe në zbatim dispozitave të Ligjit 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, Rregulloren (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, si dhe dispozitat e Statutit të Komunës nr.prot.010020/01-0050862/18 të datës 29.06.2018 (me theks neni 94 paragrafi 1), në takimin e mbajtur më 19 gusht 2026, pas diskutimeve lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Podujevës si dhe çështje tjera në kuadër të kësaj teme, propozimeve të dhëna, si dhe shqyrtimit të iniciativës së propozuar nga Kryetari i Komunës, propozohet ky:

DRAFT

S T A T U T **PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS** **NR.PROT.01-020/01-0050862/18 TË DATËS 29.06.2018**

Neni 1

1. Me këtë Statut plotësohet dhe ndryshohet Statuti (bazë) nr.prot.01-020/01-0050862/18 i datës 29.06.2018 i Komunës së Podujevës, si në vijim:

1.1. Neni 4 i Statutit bazë, pjesa e tekstit përkatësisht numri i selisë së Komunës së Podujevës ku figuron 49, bëhet **nr.109**

1.2. Neni 64 paragrafi 2 i Statutit bazë, plotësohet duke u shtuar edhe një Drejtori, si në vijim; **2.12. Drejtorja për Investime Kapitale**

1.3. Neni 89 paragrafi 4 i Statutit bazë riformulohet si në vijim:

Autoriteti mbikëqyrës është i obliguar të jap mendimin e tij për ligjshmërinë e çdo akti të regjistruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe Ligjin për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave

Neni 2

Pjesët tjera të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29.06.2026, mbeten të pandryshuara.

Neni 3

Ky Statut është pjesë përbërës e Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29.06.2018.

Neni 4

Pas shqyrtimit dhe miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, i njëjti hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave.

Arsyetim

➤ Neni 4 i Statutit bazë ndryshohet dhe plotësohet për shkak se me ish sistemin e adresave numri i selisë së Komunës së Podujevës ka qenë 49, kurse me sistemin e ri të adresave numri i selisë së adresës së Komunës së Podujevës është 109.

➤ Neni 64 i Statutit bazë ndryshohet dhe plotësohet, përkatësisht shtohet një Drejtori e re, Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe arsyeja e shtimit / themelimit të kësaj Drejtorie, ndër të tjera, rrjedh si nevojë e organizimit të administratës komunale me qëllim të funksionimit sa më efikas si dhe përmirësimit të planifikimit, koordinimit dhe zbatimit të projekteve dhe investimeve kapitale në kuadër të një Drejtorie të veçantë të administratës së Komunës së Podujevës.

Gjithashtu nevoja për krijimin e Drejtorisë për Investime Kapitale ndërlidhet me vëllimin dhe numrin e lartë të projekteve kapitale që realizohen nga Komuna e Podujevës.

Në administratën komunale planifikohet riorganizim në mënyrë që në kuadër të kësaj Drejtorie të sistemohen funksione dhe sektorë varësisht fushëveprimit përkatës në kontekstin e investimeve kapitale që aktualisht veprojnë në kuadër të Drejtorive të tjera, me theks në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit si dhe në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjen e Mjedisit, kjo në mënyrë që investimet dhe projektet kapitale të përkufizohen dhe koncentrohen në një Drejtori të vetme (Drejtoria Investimeve Kapitale) si kompetencë, përgjegjësi dhe fushëveprimtari e veçantë për krijimin e mundësive të planifikimit më të mirë të investimeve kapitale; koordinim më efikas të projekteve infrastrukturore, përcaktim më të qartë të përgjegjësive institucionale; menaxhim dhe përcjellje më të mirë të realizimit të projekteve, rritje të efikasitetit në realizimin e investimeve kapitale, koordinim më të mirë ndërmjet planifikimit, projektimit dhe realizimit të projekteve, shmangie të mbivendosjes së kompetencave ndërmjet Drejtorive, administrim më funksional të proceseve që lidhen me investimet kapitale të Komunës.

➤ Neni 89 paragrafi 4 i Statutit bazë, ndryshohet dhe plotësohet duke u riformuluar në tërësi për shkak të ndryshimit të procedurave ligjore sa i përket shqyrtimit administrativ të akteve të komunave, përkatësisht nxjerrjes së Ligjit të ri për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave i cili ndër të tjera parasheh afate dhe procedura tjera në raport me Ligjin për vetëqeverisje lokale.

Podujevë
19.08.2026